



REPUB LIKA E KOSOVËS

Komuna Drenas/Gllogoc

Zyra e Personelit

01Nr. 119-54166 dt. 12.03 /2019

Bazuar në nenin 3 paragrafi 2, nenin 11 paragrafi 1, neni 12 paragrafi 3, neni 18 paragrafi 1, nenin 20 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenet 14,15,16 të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Drenas/Gllogoc, shpallë:

KONKURS PUBLIK

Udhëheqës i Sektorit të ndërtimit

Emri i institucionit rekrutues: Komuna Drenas/Gllogoc
Nr. i references: RN00005752
Pozita e punës: Udhëheqës i Sektorit të Ndërtimit- UNM/020
Institucioni: Drejtorati i Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit
Divizioni/njësia: Sektori i Ndërtimit
Lloji i pozitës: I Karrierës
Tipi i akt emërimit të punës: Orar të Plotë
Pozita e punës së mbikëqyrësit: Drejtori
Kategoria Funksionale –Grada Niveli Drejtues, Koeficienti 8,5
Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit: Po
Procedura e Aplikimit: I Jashtëm
Numri i kërkuar: 1 punëtor/e
Kohëzgjatja e emërimit: I përhershëm
Kategoritë funksionale dhe gradat e punës, vendndodhja e pozitave: Niveli Drejtues, grada 7
Koeficienti 8, 5 Drejtorati i Planifikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit në Administratën Komunale - Drenas.

Përmbledhje e shkurtër e përshkrimit të punës,qëllimi,detyrat dhe përgjegjësit kryesore për pozitën: Udhëheqës i Sektorit të Ndërtimit .

Detyrat Kryesore:

1. Menaxhon punën e përgjithshme të sektorit dhe ndihmon Drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave;
2. Menaxhon stafin e sektorit dhe në bashkëpunim me Drejtorin, organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit për të ofruar produkte dhe shërbime cilësore;
- 3.Ndihmon Drejtorin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime / përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
4. Menaxhon ofrimin e produkteve dhe shërbimeve në fushën e ndërtimit ;
5. Zhvillon dhe propozon politika në lidhje me prurjen e vendimeve për hartimin dhe rregullimin e projekteve ;

6. Koordinon me departamentin ligjor të institucionit rreth çështjeve ligjore të shfaqura në lëminë e ndërtimit;
7. Koordinon punën dhe bashkëpunon me menaxherët tjerë në institucion;
8. Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerje të detyrave të tyre në përputhje me standardet e kërkuara.

Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja paraprake e punës:

Diplomë universitare - Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës - Drejtimi Ndërtimtar,
4 vite përvojë pune profesionale.
Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, AutoCad, Plateia);
Shkathtësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues;
Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë dhe Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
Njohuri dhe përvojë substanciale në lëminë e ndërtimit;

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë, sporteli nr.10-12, gjatë orarit të punës, Qendra për Shërbimin e Qytetarëve.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetët e Kosovës.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, të mangëtat refuzohen. Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten: kopje e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës, certifikata e kandidatit që nuk është nën hetime, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kritereve të konkursit. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, që nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik, në një gazetë të përditëshme dhe në web-faqen e Komunës, nga data **12/09/2019 deri më 26/09/2019**, për pozitën e cekur më lart.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes web faqes së Komunës dhe shpalljes në hyrje të Komunës.



Udhëheqëse e Personelit

Hamshah Shabani